
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data 02.07.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: FURNIZIM DHE VENDOSJE KOMPRESOR AJRI PËR
PËRDORIME MJEKËSORE**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Kompresor ajeri 42123400-1

Vlera e fondit limit: 4,162,800 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”,

Bazuar në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që

plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Bazuar në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “ 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës e fondit limit të kontratës është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19%** e vlerës e fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Bazuar në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallin objekt prokurimi. Në rastin e distributorit të autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,*

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në neni 40/3/ 8“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik, pasi vërteton që prodhuesi/ distributor i autorizuar, autorizojnë operatorin ekonomik të tregtojë mallin e tij në Republikën së Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kerkese për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallrat, me garanci e suport teknik dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues

Nisur nga rëndësia që ka kompresori i ajrit për përdorim mjekësorë, për punën e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, njësia e prokurimit gjykon se, ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin dhe është në proporcion me objektin e kësaj procedure prokurimi, dhe nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi si dhe nuk e ulin konkurrencën dhe në këtë kuadër.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi për kompresorin e ajrit, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të tyre, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e mallit të ofruar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një

standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallin e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallit të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi” të ndryshuar, e cila të përfshijë kategorinë e mëposhtme:

- N.S- 12-A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se:”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”;

Në Ligjin Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” neni Neni 5 përcaktohet se “1. Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion kryhet vetëm nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi. 2. Instaluesi kryen montimin e pajisjeve/

instalimeve nën presion, në përputhje me rregullat e rregulloret teknike përkatëse, dhe është përgjegjës për garantimin e kërkesave thelbësore të sigurisë së montimit të pajisjes/instalimit nën presion. 3. Pasi montohet dhe përpara vënies në shfrytëzim, pajisja/instalimi nën presion i nënshtrohet inspektimit teknik prej organeve të miratuara/notifikuara.”

Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 pika 1, ku përcakton se: “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” dhe V.K.M Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, ku nën nenin 1 pika 1 përcaktohet se: “1. Qëllimi dhe fusha e veprimit: Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij. Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.” dhe lidhjes 2 dhe 3 të këtij vendimi:

“Shpjegime për kategoritë endërtimeve(punimeve)speciale: **N.S- 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.** Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punime murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.”

Në lidhjen 4 të vendimit është bërë klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi, ku sipas vlerës së objektit të prokurimit që do të realizohet, ku niveli i kategorisë së kërkuar është “A”. Kategoria dhe niveli i kërkuara është në përputhje me objektin e prokurimit për furnizim dhe vendosje kompresor ajëri për përdorim mjekësor. Kërkesa për kategoritë e licences që duhet të ketë operatori ekonomik pjesmarrës është vendosur në përputhje me vlerën dhe objektin e kësaj procedure prokurimi, punimeve që do të kryhen për realizimin e kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Deklaratë konformiteti CE të mallit objekt prokurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Në nenin 44 pika 1 të të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se

punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”.

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” neni 3 pika 26 ku përcaktohet se “*Deklaratë konformiteti CE*” është dokumenti i hartuar nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit apo, sipas rastit, të instaluesit të pajisjes/instalimit nën presion, i cili përshkruan të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj pajisjes/instalimit, përfshirë edhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse të përputhshmërisë me rregullat teknike dhe rregulloret përkatëse.” dhe neni 6 Deklarata e konformitetit “CE” ku përcaktohet se “1. Çdo pajisje/instalim nën presion, përpara hedhjes në treg dhe vënies në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit “CE”, të lëshuar nga prodhuesi, ku përfshihet edhe procedura e vlerësimit të konformitetit për fazën e shfrytëzimit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse. 2. Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion bëhet nga subjekte instaluese, të pajisura me licencat përkatëse, të cilat janë detyruara të lëshojnë deklaratën e konformitetit “CE” për instalimin nën presion, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse.”. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, për të provuar se pajisja plotëson të gjitha standartet e cilësisë sipas legjislacionit në fuqi dhe për të siguruar autoritetin kontraktor përfitues se malli plotëson standartet e kërkuara dhe është i sigurt për për t'u përdorur për qëllimin e kërkuar.

6. Operatorët ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik të përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik

Për punojësin e mësipërm duhet të paraqiten:

- Diploma e shkollës së lartë
- Kontrata e punës individuale (të vlefshme)
- CV

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për realizimin e kontratës, si më poshtë:

- a) Minimalisht 1 (një) Specialist të certifikuar për përdorim/instalim të pajisjeve nën presion.

Për punojësin e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontrate pune/kontratë bashkëpunimi (të vlefshme).
- Çertifikatën përkatëse (e vlefshme), lësuar nga subjekte të akredituar për certifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/ instalime nën presion.

- b) Minimalisht 1 (një) Specialist elektrikist

c) Minimalisht 1 (një) Specialist mekanik

Për punojësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Shënim: Kërkesa për 1 (një) Specialist të certifikuar për përdorim/instalim të pajisjeve nën presion mund të plotësohet edhe nga specialistët e tjerë të kërkuar në kriterin 6 dhe 7.

Shënim: Kriteri 6 dhe 7 si më sipër konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave të kërkuara më sipër ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa 6 dhe 7 si më sipërme janë bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 5 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike si dhe brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me shërbimet që do të kryhen në funksion të furnizimit dhe vendosjes së kompresorit të ajërit për përdorim mjekësor. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantojë që realizimi i kontratës do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike pasi nuk kemi të bëjmë vetëm me furnizim të kompresorit të ajërit për përdorim mjekësor, por edhe me vendosjen/instalimin të tij, duke e integruar/përshtatur me sistemin ekzistues që ka Spitali Rajonal "Memorial" Fier. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/ akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh." të ndryshuar. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në "regjistrat profesionale" të AKAFP-se.

Kërkesa për "Specialist të certifikuar për përdorim/instalim të pajisjeve nën presion" është vendosur në zbatim të Ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" neni 8 pika 6 ku përcaktohet se "*6. Operatori ekonomik ka përgjegjësi që, në çdo rast, përdorimi i pajisjeve/instalimeve nën presion të bëhet nga punëmarrës që ka përgatitje të dokumentuar me dëshmi aftësie, e cila lëshohet nga një organ i miratuar nga ministri, i akredituar për certifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/ instalime nën presion.*"

Për të realizuar këtë objekt prokurimi, që përfshin furnizimin dhe vendosjen/instalimin e kompresorit të ajërit për përdorim mjekësor, nevojitet një ekip i kombinuar specialistësh si më poshtë:

- Minimalisht **1 (një) Inxhinier Mekanik**

Ky është specialisti i rëndësishëm për organizimin e punës për realizimin e projektit për instalimin dhe integrimin/përshtatjen e kompresorit të ajërit për përdorim mjekësor me sistemin ekzistues të furnizimit me ajër mjekësor, kontrollin e të gjitha aspekteve të tjera të punës që do të kryhen nga specialistët e tjerë, sipas kërkesave në specifikime teknike

- Minimalisht **1 (një) Specialist elektrikist**

Ky specialist do të kryejë instalime elektrike, të tokëzimit dhe lidhjejt elektrike me sistemin ekzistues, të motorëve dhe testimet elektrike të rrjetit.

- Minimalisht **1 (një) Specialist mekanik**

Montimin e fizik të kompresorit, rezervuarëve nën presion, lidhje e sistemit të kompresorit me të gjithë elementët dhe përshtatja me linjën ekzistuese, sipas kërkesave në specifikimet teknike.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalent;

- ISO 45001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”* Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".* Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar/vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. Nisur nga natyra e objektit të prokurimit, ku kemi jo vetëm furnizim mallrash por edhe shërbime dhe punime të lidhura me mallrat, si punime elektrike apo mekanike është e rëndësishme që operatorët ekonomikë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në parimin të sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve të tyre.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i kontratës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

9.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i garancisë së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë*

se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në rastin konkret është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar pëson defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit

për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Spitali Rajonal “Memorial” Fier, si më poshtë:

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Për hartimin e specifikimeve teknike, Grupi i Punës është bazuar në kërkesën e sektorit të teknikës, planifikimin vjetor, standardet në fuqi për ajrin me përdorim mjekësor, si dhe në nevojat reale të konsumimit të ajrit mjekësor nga pavionet, repartet dhe njësitë jetike me përgjegjësi të lartë, si sallat e operacionit, reanimacioni, si dhe pajisjet spitalore të tjera.

Në institucionin tonë, që nga ndërtimi i Spitalit në vitin 2021 dhe gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit me kapacitet të plotë të pavioneve, është konstatuar një ngarkesë e lartë teknike mbi kompresorët e instaluar, mbi normat e përcaktuara në katalogët teknikë. Kjo situatë është shkaktuar nga disa faktorë, ndër të cilët:

- shfaqja e defekteve të herëpashershme, përfshirë djegien e elektromotorëve dhe grupit të kompresimit;
- pamundësia për të përballuar ngarkesën e vazhdueshme të punës, duke funksionuar pa ndërprerje (24/7);
- konsum i lartë i vajit dhe nevoja për ndërrim të shpeshtë të filtrave;
- dëmtimi progresiv i grupit të kompresorit, duke e bërë në disa raste riparimin jo efektiv.

Spitali disponon në përbërje të sistemit të prodhimit të ajrit mjekësor kompresorë me kapacitet **3 m³/min** dhe fuqi **22 kW**, ku njëri prej tyre ka shfaqur defekte të përsëritura, përfshirë dëmtimin e elektromotorit, paketës elektrike, grupit të kompresimit me vida, si dhe sistemit të ftohjes ajër/vaj, duke e bërë të pamundur riparimin dhe rikthimin në funksionim normal.

Gjatë funksionimit të pavioneve si sallat e operacionit, kolonoskopitë, reanimacioni me respiratorë dhe autoklavat, është hasur shpesh pamundësia për të përmbushur kërkesën e vazhdueshme (24/7) për ajër mjekësor, duke ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore.

Nisur nga këto kushte dhe duke marrë në konsideratë rëndësinë jetike të ajrit mjekësor për funksionimin e spitalit dhe pajisjeve mjekësore, **është i domosdoshëm instalimi i një sistemi kompresori të ri, të kompletuar (set), të pavarur nga sistemi ekzistues**, me fuqi rreth **26 kW** dhe kapacitet **3–5 m³/min**.

Sistemi i kompresorit duhet të jetë i pajisur me të gjithë elementët përbërës, duke përfshirë tharësen, ndarësin vaj/ajër, depozitën dhe elementët e sigurisë, si dhe filtrat përkatës, me qëllim sigurimin e prodhimit të një ajri me cilësi të lartë dhe të përshtatshëm për përdorim mjekësor dhe jetik për pacientët dhe pajisjet spitalore.

Pajisja duhet të ketë gjithashtu:

- ekran LCD me ngjyra;
- nivel të ulët zhurme, maksimalisht **72 dB**;
- funksionim të automatizuar dhe të vazhdueshëm;
- sistem të integruar filtrimi dhe kontrolli cilësie të ajrit.

Sa më sipër kërkohet furnizim -vendosje kompresor Ajri 26 KW.

Nr.	Përshkrimi i materialit	Njësia	Sasia
1	F-V kompresor ajri 26 kw (set) per perdorim mjekesor	copë	1

Furnizimi me këtë pajisje është domosdoshmëri jetike për funksionimin e aparaturave mjekësore dhe trajtimin e pacientëve, duke siguruar prodhim të pandërprerë të ajrit mjekësor **24/7**, me cilësi të lartë dhe pa lejuar depërtimin e grimcave apo papastërtive të tjera në sistemin e tubacioneve të ajrit.

Në terminologjinë e përdorur më sipër, **“furnizim – vendosje kompresor ajri mjekësor (set)”** nënkupton të gjitha hallkat, proceset dhe fazat e instalimit të pajisjes, përfshirë montimin e të gjithë elementëve përbërës, deri në përshtatjen dhe lidhjen me linjën ekzistuese të furnizimit me ajër mjekësor të Spitalit, si dhe kryerjen e të gjitha punimeve ndihmëse të nevojshme.

Gjithashtu, përfshihet furnizimi dhe lidhja me energji elektrike nga kabina më e afërt, duke respektuar në mënyrë strikte normat dhe udhëzimet teknike për instalimet elektrike dhe pajisjet nën presion.

Një përshkrim i shkurtër jepet si më poshtë:

1. Përshkrim i Përgjithshëm

Më poshtë paraqitet projektimi, përzgjedhja dhe dimensionimi i një sistemi të ajrit të komprimuar për përdorim spitalor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Sistemi duhet të përfshijë prodhimin, trajtimin dhe ruajtjen e ajrit të komprimuar me cilësi të lartë për përdorime mjekësore dhe teknike.

2. Përbërësit Kryesorë

2.1 Kompresori i ajrit (26 kW)

- **Tipi:** Kompresor me vida (screw) me inverter (VSD)
- **Presioni:** 10 bar

Kapaciteti minimal: 231 m³/orë

Llogaritja e fuqisë:

Formula bazë:

$$P = (Q \times \Delta p) / \eta$$

Ku:

- $Q = 231.48 \text{ m}^3/\text{orë} = 0.0643 \text{ m}^3/\text{s}$
- $\Delta p \approx 1,000,000 \text{ Pa}$
- $\eta \approx 0.85$

Fuqia teorike $\approx 75 \text{ kW}$

Në praktikë, duke marrë në konsideratë:

- kompresimin me shumë faza,
- efikasitetin volumetrik,
- kontrollin me inverter,

fuqia reale e instaluar $\approx 26 \text{ kW}$

2.2 Filtrat e ajrit

- Sigurojnë filtrim të grimcave dhe vajit deri në **0.001 mg/m³**
- Garantojnë ajër të pastër për përdorim mjekësor

2.3 Tharësja (Adsorption Dryer)

- **Pika e vesës (dew point): -40°C**
- Siguron eliminimin e lagështisë për të shmangur kondensimin dhe kontaminimin

2.4 Filtrat me karbon aktiv

- Eliminon aromat dhe hidrokarburet
- Përdoret për arritjen e cilësisë së lartë të ajrit
- **Presioni maksimal:** 16 bar
- **Kapaciteti:** 360 m³/orë

2.5 Depozita e ajrit

- **Kapaciteti:** 800–1000 L
- **Funksioni:** Stabilizimi i presionit dhe sigurimi i rezervës së ajrit

3. Standardet e Cilësisë së Ajrit

Sistemi duhet të jetë në përputhje me **Standardin ISO 8573-1**, i cili përcakton klasat e cilësisë së ajrit të komprimuar:

- **Grimcat:** Klasa 1
 - **Uji:** Klasa 2 (dew point -40°C)
 - **Vaji:** Klasa 1 (≤ 0.01 mg/m³)
-
- Periudha e garancise 12– muaj nga data e kolaudimit/certifikimit nga Ishti.
 - Afati maksimal i realizimit të furnizi –vendosjes jo më shumë se 6 javë.
 - Prodhim kompresorit minimumi jo më i vjetër se viti 2025.
 - Detyrë e OE plotësimi i të gjithë dokumentacioneve për certifikim dhe kolaudim sipas akteve ligjore në fuqi tek Ishti.
 - Nese brenda periudhes se garancise shfaqet nje defekt qe lidhet me montimin e gabuar ose mos-inspektimin e duhur te sistemit ,operatori ekonomik mban pergjegjesi pasi kompresori eshte paisje kritike per jeten e pacienteve, por dhe riparimin e tij pa kosto shtese.
 - O.E duhet të kryejë të gjitha punimet ndihmëse për përshtatjen dhe instalimin e kompresorit,të tilla si: përshtatja/adoptimi me linjën ekzistuese të furnizimit,furnzimi me energji elektrike e komrpresorit nga gabina më e afërt,si dhe sharkimi i ujërave të depozitës në pusëtën më të afërt,etj.
-
- **Argumentime teknike për specifikimet:**

i. Argumentimi inxhinierik i fuqisë së kompresorit:

Dimensionimi i fuqisë së kompresorit nuk përcaktohet në mënyrë arbitrare, por bazohet në llogaritje termodinamike dhe mekanike të procesit të kompresimit të ajrit.

Formula bazë e fuqisë teorike:

$$P = (Q \times \Delta P) / \eta$$

ku:

P = fuqia e nevojshme (kw)

Q = prurja volumetrike e ajrit (m^3/s)

ΔP = diferenca e presionit (Pa)

η = rendimenti total mekanik dhe elektrik.

Në rastin konkret:

- Kapaciteti operacional: 3–5 m^3/min
- Presioni i punës: 10 bar
- Humbjet në rrjet, filtrat dhe tharësi rrisin ngarkesën reale të sistemit.
- Sistemi duhet të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme 24/7.

Për këtë arsye, fuqia teorike e sistemit rezulton afërsisht 75 Kw, ndërsa fuqia reale e instaluar rreth 26 kw për njësi operative, në varësi të konfigurimit të kompresorëve, ciklit të punës dhe sistemit redundand (backup).

Në projektimet e sistemeve të ajrit mjekësor përdoren gjithmonë koeficient sigurie, pasi pajisja nuk duhet të punojë vazhdimisht në ngarkesë maksimale. Kjo shmang mbinxehjen, konsumimin e parakohshëm dhe rënien e presionit në rrjet.

ii. Argumentimi teknik i kapacitetit 3–5 m^3/min dhe 231 $m^3/orë$:

Kapaciteti i kërkuar është përcaktuar mbi bazën e konsumit real të pajisjeve mjekësore, ventilatorëve, respiratoreve, aparaturave të anestezisë, sallave operacionit, sallat e reanimacionit, autoklavave, njësive të terapisë intensive dhe gjitha dhomave të pacientit dhe shërbimeve që spitali ka në përbërje. Duhet patur parasysh që spitali ka një sipërfaqe prej 13000 m^2 , ka në përberje të tij 130 dhoma pacienti të gjitha të pajisura me prize për gaze mjekësore, ka 20 dhoma reanimacioni, 6 salla operatore etj.

Në projektimin e sistemeve mjekësore, kapaciteti nuk dimensionohet vetëm mbi konsumin aktual, por mbi:

- ngarkesën maksimale të mundshme;
- zgjerimin e mundshëm të shërbimit;
- koeficientin e sigurisë;
- rezervën teknike për emergjenca.

Kapaciteti minimal 231 $m^3/orë$ siguron:

- stabilitet presioni;
- furnizim të pandërprerë;
- shmangien e rënieve të performancës;
- funksionim paralel të disa pajisjeve kritike.

Arsyeja përse nuk mund të kalohet në kapacitete më të larta se ky kufi është ruajtja e parametrave teknik të instalimit të linjave, duke mos rrezikuar linjat, pasi presioni më i lartë kërkon linja me spesor më të lartë et,

iii. Argumentimi i presionit 10 bar

Presioni 10 bar është standard teknik i përdorur në sistemet e ajrit të kompresuar me shpërndarje në distanca të konsiderueshme, standart ky që është ruajtur edhe nga firma që ka ndërtuar Spitalin ku kompresori I instaluar është me presion 10 bar. Ndaj dhe është përcaktuar që të sigurohet funizim i qëndrueshëm në të gjithë rrjetin për të plotësuar pikat si më poshtë :

Ky presion kërkohet për:

- kompensimin e humbjeve lineare në tubacione të cilat kanë dimensione të ndryshme teknike, ngushtime, brryla degëzime të cilat rrisin rezistencën teknike dhe ndikojnë në zvogëlimin e presioneve në pikat fundore si dhe në degëzimet e linjave ku janë të montuara paisjet të cilat kërkojnë ajrin, dhe linja shumë të gjata me një distancë nga dhoma teknike qendrore ku do instalohet kompresori deri në pikën fundore me mbi 170 m distancë ajrore pa marrë në konsiderat degëzimet.
- humbjet në filtra dhe tharëse;
- garantimin e presionit minimal në pikat terminale;
- rezervën operative në rast ngarkesash të menjëhershme, pasi paisjet mund të kërkojnë ajër njëkohësisht në pikun e ngarkesës dhe shfrytëzimit të Spitalit.

Presioni më i ulët mund të sjellë:

- mosfunksionim të pajisjeve mjekësore;
- rënie të fluksit;
- ndërprerje të funksionimit të paisjeve jetike
- alarme dhe ndërprerje operative.

iv. Filtrimi dhe dew point -40°C

Pika e vesës (dew point) -40°C është standard industrial dhe mjekësor për eliminimin e lagështisë në ajrin e kompresuar. ISO 8573-1

Lagështia në rrjet shkakton:

- korrozion të tubacioneve;
- zhvillim bakterial;
- dëmtim të valvulave dhe pajisjeve;
- rrezik për pacientët.

Filtrimi në nivelin 0.001 mg/m³ është kërkesë për garantimin e pastërtisë së ajrit mjekësor dhe eliminimin e vajrave dhe grimcave mikroskopike, vajrat dëmtojnë paisjet mjekësore.

v. Argumentimi i nivelit të zhurmës 72 Db:

Kufiri maksimal 72 dB është përcaktuar për respektimin e kushteve të punës në ambientet spitalore dhe minimizimin e ndotjes akustike.

Në mjediset spitalore:

- niveli i lartë i zhurmës ndikon tek pacientët;
- ndikon në performancën e personelit;

- krijon stres akustik dhe problematika operacionale.
Për këtë arsye kërkohen kompresorë me nivel akustik dhe izolim vibracionesh.

- **Argumentimi ligjor:**

Sipas nenit 36 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, specifikimet teknike hartohen mbi bazën e nevojave funksionale dhe performancës së kërkuar.

Në rastin konkret:

- specifikimet nuk favorizojnë markë të caktuar;
- parametrat janë të lidhur drejtpërdrejt me sigurinë dhe funksionalitetin;
- kërkesat bazohen në standarde europiane dhe praktika inxhinierike, si dhe në historikun e shfrytëzimit të Spitalit pasi kompresori I Instaluar me të dhëna teknike 22 kw, presion 10 bar, kapacitet 3m³/min si dhe shfrytëzim maksimal 24/7 ka vënë herë pas here në vështirësi stafin e teknikës dhe mirëmbajtjes.

Direktiva PED 2014/68/EU ose ekuivalente kërkon që pajisjet nën presion:

- të jenë të certifikuara;
- të kalojnë kontrolle sigurie;
- të kenë dokumentacion teknik dhe deklaratë konformiteti.

LIGJI Nr. 32/2016 “PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE NËN PRESION” neni 5,6,7 shpjegon kategorizimin e paisjes nën presion, montimin, deklaratën e konformitetit, regjistrimin dhe instalimin e tyre.

Kërkesa për CE dhe standarde ISO është e lidhur drejtpërdrejt me sigurinë operative dhe jo me kufizimin e konkurrencës.

- **Argumentimi ekonomik:**

Ekonomikisht, investimi në pajisje me standard të lartë ul kostot afatgjata të mirëmbajtjes dhe ndërprerjeve operative.

Një sistem me kapacitet të pamjaftueshëm sjell:

- konsum më të lartë energjie;
- amortizim të shpejtë;
- kosto riparimesh;
- ndërprerje shërbimi;
- risk për pajisjet mjekësore.

Pajisjet moderne me rendiment të lartë:

- reduktojnë konsumin energjetik;
- rrisin jetëgjatësinë;
- minimizojnë kohën jashtë pune;

- ulin kostot operative afatgjata.

Arsyet teknike për këtë kërkesë janë:

1. Instalimi elektrik:

Kompresorët me fuqi të lartë kërkojnë:

- linja trefazore;
- mbrojtje termike;
- panele automatizimi;
- parametrizim inverterash dhe kontrollorësh.

2. Sistemi mekanik:

Kërkohet:

- montim i rezervuarit nën presion, lidhja e sistemit të kompresorit me të gjithë elementët si dhe përshtatja me linjën ekzistuese;
- instalim filtrash dhe tharësesh;
- testim rrjedhjesh;
- balancim i presioneve.

3. Automatizimi:

Sistemi duhet të monitorojë:

- presionin;
- temperaturën;
- alarmet;
- ciklet e punës;
- kalimin automatik në backup.

4. Siguria:

Pajisjet nën presion paraqesin risk të lartë teknik dhe kërkojnë personel të kualifikuar për:

- testet hidrostatike;
- kontrollin e valvulave;
- kolaudimin final;
- certifikimin e sigurisë.

5. Vazhdimësia operative:

Objekti spitalor nuk mund të mbetet pa furnizim me ajër mjekësor. Për këtë arsye kërkohet ekip i mjaftueshëm për realizim të shpejtë, montim dhe minimizim të kohës jashtë funksionit në rast defektesh gjatë periudhës së garancisë.

- **Afati i realizimit jo më shumë se 6 javë**

Afati i realizimit është përcaktuar për shkak të rëndësisë kritike të furnizimit me ajër mjekësor dhe nevojës për evitimin e ndërprerjeve në shërbimin spitalor. Sistemi konsiderohet infrastrukturë kritike dhe kërkon zbatim në kohë optimale.

- **Prodhim jo më i vjetër se viti 2025**

Kërkesa për pajisje prodhim i ri garanton jetëgjatësi më të lartë, mbështetje teknike nga prodhuesi, disponueshmëri pjesësh këmbimi dhe efikasitet energjetik më të mirë. Pajisjet e prodhimit të vjetër mund të paraqesin risk operacional dhe vështirësi mirëmbajtjeje.

- **Konkluzion**

Specifikimet teknike të kërkuara janë proporcionalisht të lidhura me natyrën kritike të objektit të prokurimit dhe justifikohen plotësisht në aspektin teknik, inxhinierik, ligjor dhe ekonomik.

Parametrat e kërkuar garantojnë:



- sigurinë e pacientëve;
- cilësinë e ajrit mjekësor;
- funksionim të pandërprerë;
- jetëgjatësi të sistemit;
- përputhshmëri me standardet europiane;
- eficiencë operative dhe ekonomike.



Paraqitje skematike

Në specifikimet teknike është mbajtur në konsiderat realizimi I objektit të furnizim vendosje me kompresor me qëllim përballimin e kapacitetit të kërkuar nga pajisjet mjekësore. Kompresori aktual është me presion pune 10 bar dhe fuqi 22 kw si dhe kapacitet 3 m³/min ,I cili ka pasur anomaly pasi ka punuar maksimalisht 24/7 për të përballuar kapacitetin e kërkuar/nevojën për konsum të paisjeve mjekësore . Për këtë qëllim,ashtu siç u relatua në fillim të këtij teksti është kaluar nga një kompresor 22 kw në një kompresor 26 kw me kapacitet **3–5 m³/min**, duke mos e tejkaluar pafundësisht fuqinë dhe kapacitetin pasi mund të sjellë dëmtime të linjave aktuale(spesori linjave ,ku linjat e ndryshme kanë spesor të ndryshëm,tegelet e saldimit,brrylat,degëzimet etj).

Është kërkuar përshtatja me linjën aktuale që ndodhet në dhomën teknike ku dhe do instalohet kompresori i ri,sipas paraqitjes skematike bashkalidhur ,por në asnjë moment nuk janë parashikuar distancat fikse pasi kushtëzojn parametrat fizike dhe gabarite të vet kompresorit dhe sistemit në tërësi.

DHOMA TEKNIKE





Vendi i dorëzimit: Spitali Rajonal “Memorial” Fier

Për ngarkimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, njësia e prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin.

NJESIA E PROKURIMIT